



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
 Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 1075Datë: 16/07/2025

RAPORT VLERËSIMI TË DORËSHKRIMIT TË PUNIMIT TE DIPLOMES
MASTER

FAKULTETI	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike
Departamenti/ Programi	Prodhimtari dhe Inxhinieri Industriale me Menaxhment
Projektpropozimi	OPTIMIZIMI I PROCESIT TË PROKURIMIT TË PAJISJEVE PERSONALE MBROJTËSE (PPM) NË SEKTORIN E PRODHIMIT Optimising Personal Protective Equipment (PPE) Procurement in Manufacturing
Kandidati	BSc. Frosina Sopi
Mentori	Prof. Dr. Mirlind Bruçi
Aprovimi i projekt propozimit në Këshillin e Fakultetit	Datë: 20.03.2025
	Vendimi nr.: 2-436/2
<p>Vlerësimi i dorëshkrimit</p> <p>Në bazë të vendimit nr. 2-436/2 të datës 20.03.2025, të Këshillit të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike në Prishtinë, është formuar komisioni në përbërje:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Prof. Dr. Ramë Likaj, kryetar 2. Prof. Asoc. Dr. Xhevahir Bajrami, anëtar 3. Prof. Dr. Mirlind Bruçi, mentor <p>Për vlerësimin e punimit Master me titull “Optimizimi i procesit të prokurimit të pajisjeve personale mbrojtëse (PPM) në sektorin e prodhimit” të kandidatit Frosina Sopi. Pas shqyrtimit të punimit të lartpërmendur, Komisioni jep këtë:</p> <p style="text-align: center;">R A P O R T</p> <p>Punimi Master me titull “Optimizimi i procesit të prokurimit të pajisjeve personale mbrojtëse (PPM) në sektorin e prodhimit” është strukturuar në kapituj kryesorë dhe është ilustruar me figura, grafe dhe tabela të nevojshme.</p>	

Hyrje

Ky kapitull shqyrton rëndësinë e prokurimit të mirë menaxhuar të Pajisjeve Personale Mbrojtëse (PPM) si një komponent kyç i sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës në sektorin e prodhimit. Punimi trajton balancimin ndërmjet përmbushjes së standardeve të sigurisë dhe kufizimeve buxhetore, duke propozuar një qasje të integruar dhe të bazuar në të dhëna për përmirësimin e efikasitetit operacional dhe mbrojtjen e punëtorëve.

Siguria në punë

Në këtë kapitull jepen parimet bazë të sigurisë në punë, duke u përqendruar në pozicionimin e PPM-ve brenda hierarkisë së masave parandaluese. PPM-të analizohen si masa e fundit e mbrojtjes për punëtorët në ambiente me rrezik të lartë, duke theksuar rëndësinë e përzgjedhjes së duhur të tyre në përputhje me rreziqet e identifikuara.

Pajisjet personale mbrojtëse (PPM)

Ky kapitull analizon llojet kryesore të PPM-ve si këpucët, dorezat, syzet, maskat, helmetat dhe pajisjet për mbrojtjen nga zhurma. Secila nga këto pajisje trajtohet në mënyrë të detajuar sipas standardeve evropiane dhe qëllimeve mbrojtëse. Për çdo pajisje, përmendet rreziku që synon të shmangë, standardi përkatës dhe kriteret për certifikim. Krahas kësaj, theksohet rëndësia e përdorimit të PPM-ve të cilësisë së lartë për të garantuar sigurinë. Kjo pjesë e punimit mbështetet edhe me ilustrime dhe dokumente të certifikimit nga furnitorë.

Praktikat e prokurimit të PPM-ve dhe kriteret e furnizimit

Ky kapitull diskuton se si kompanitë identifikojnë, porosisin dhe shpërndajnë PPM-të, duke balancuar cilësinë, koston dhe afatet e furnizimit. Vlerësohet rëndësia e planifikimit buxhetor, kontratave afatgjata dhe përdorimit të softuerëve për menaxhimin e stokut. Krahas kësaj, theksohet edhe rëndësia e negociatave me furnitorët për çmime më të favorshme. Shpjegohet se si investimi në cilësi të lartë ndikon pozitivisht në sigurinë afatgjatë. Përmendet edhe rëndësia e edukimit dhe trajnimeve për përdorimin korrekt të pajisjeve.

Roli i vlerësimit të riskut në vendimmarrje

Ky kapitull shpjegon se si vlerësimi i riskut ndihmon në zgjedhjen e PPM-ve më të përshtatshme. Ai është i domosdoshëm për identifikimin e rreziqeve që nuk eliminohen dot me masa teknike dhe për të ndihmuar në përcaktimin e përparësive të investimit. Ky proces ndihmon që kompanitë të mos shpenzojnë pa strategji, por të fokusohen te rreziqet më serioze. Vlerësimi duhet të përsëritet në rast ndryshimesh në ambientin e punës.

Raste studimore

Analizohen dy kompani prodhuese në Kosovë: VAVI dhe RELUX. Të dyja kanë kryer vlerësime të riskut dhe kanë zbatuar masa parandaluese, duke përfshirë përdorimin e PPM-ve si helmeta, këpucë S3, doreza, syze dhe maska. Ndërsa VAVI fokusohet më shumë në pajisje të domosdoshme për linjën e montimit, RELUX përfshin masa më të specializuara për mbrojtje nga kimikatet. Vlerësimi tregon përmirësime të ndjeshme pas implementimit të masave.

Analiza e bazës së të dhënave të një furnitori të PPM-ve

Ky kapitull shqyrton trendet e blerjes së PPM-ve nga një furnitor vendor gjatë viteve 2017-2024. Të dhënat tregojnë rritje të ndjeshme të investimeve në siguri, me fokus të veçantë në veshjet

Formulari- F2

dhe këpucët. Megjithatë, disa kategori si mbrojtja e kokës dhe dëgjimit janë më pak të financuara.

Qasjet e kompanive të prodhimit ndaj prokurimit dhe përdorimit të PPM




Ky kapitull analizon rezultatet e një ankete të zhvilluar me 21 kompani prodhuese në Kosovë, për të kuptuar praktikën reale të prokurimit dhe menaxhimit të PPM-ve. Të dhënat tregojnë se kompanitë janë të vetëdijshme për rëndësinë e PPM-ve dhe bëjnë blerje të rregullta. Megjithatë, menaxhimi i tyre mbetet shpesh spontan dhe pa sistem të mirëfilltë. Zgjedhja e furnitorëve ndikohet më shumë nga çmimi sesa nga certifikimi apo përputhja me standardet.

P Ë R F U N D I M

Në bazë të të dhënave të përshkruara më lart, Komisioni për Vlerësimin e punimit Master konsideron se punimi është hartuar në nivel të duhur, i pasqyruar me figura, diagrame dhe tabela të nevojshme. Prandaj, komisioni i propozon Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike në Prishtinë, që punimin Master me titull **“Optimizimi i procesit të prokurimit të pajisjeve personale mbrojtëse (PPM) në sektorin e prodhimit”** të kandidatës **Frosina Sopi**, ta aprovojë si punim për Master dhe ta japë në diskutim publik.

Prishtinë,

Komisioni:

1. 
Prof. Dr. Ramë Likaj – kryetar
2. 
Prof. Asoc. Dr. Xhevahir Bajrami – anëtar
3. 
Prof. Dr. Mirlind Bruçi – mentor

Abstrakti

Ky punim trajton temën e optimizimit të prokurimit të Pajisjeve Personale Mbrojtëse (PPM) në sektorin e prodhimit, një fushë e ndjeshme ku ndërthuren çështjet e sigurisë në punë, menaxhimit të riskut dhe menaxhimit të furnizimit. Në qendër të analizës qëndron sfida e arritjes së një ekuilibri ndërmjet sigurimit të kushteve të duhura për punëtorët dhe kufizimeve buxhetore të kompanive prodhuese. Qëllimi kryesor i këtij studimi është të propozojë zgjidhje të zbatueshme për rritjen e efikasitetit operacional dhe përmirësimin e standardeve të sigurisë, përmes një qasjeje të strukturuar dhe të bazuar në të dhëna.

Metodologjia e ndjekur përfshin një kombinim të vlerësimit të riskut në dy kompani prodhuese (VAVI dhe RELUX), një anketë të zhvilluar me 21 kompani të sektorit të prodhimit dhe analizën e të dhënave reale të furnizimit nga një furnitor PPM-sh në Kosovë, me rreth 500 klientë nga prodhimi. Vlerësimi i riskut shërben si bazë themelore për identifikimin e nevojave për PPM, duke mundësuar vendimmarrje të informuar dhe përparësi në mbrojtjen e punëtorëve në mjediset me rrezik të lartë.

Rezultatet tregojnë se edhe pse ekziston një vetëdije në rritje për rëndësinë e PPM-ve, praktikatat aktuale të prokurimit shpesh nuk bazohen në analiza të thelluara të riskut dhe as në planifikime të integruara financiare. Kompanitë shpesh vendosin për PPM-të në mënyrë të rastësishme, duke u fokusuar në çmim dhe jo në jetëgjatësi, performancë apo certifikime. Nga ana tjetër, të dhënat tregojnë se përdorimi i PPM-ve me cilësi të lartë dhe menaxhimi aktiv i stokut kanë ndikim pozitiv në sigurinë e punonjësve dhe performancën e kompanisë.

Punimi rekomandon implementimin e softuerëve për menaxhimin e PPM-ve, integrimin e planifikimit të tyre në buxhetin vjetor të kompanive, si dhe thellimin e përdorimit të vlerësimeve të riskut si bazë për vendimmarrje. Për më tepër, theksohet rëndësia e trajnimeve të rregullta për përdorim të saktë të PPM-ve, duke qenë se edhe pajisjet më të avancuara humbin efektin nëse përdoren në mënyrë të pasaktë.